



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR PROVUES

Viti shkollor 2017/2018

TESTI GJUHË SHQIPE

UDHËZIM PËR PUNË

- Testi përmban **20** detyra të cilat duhet t'i zgjidhësh për **120** minuta.
- Secilën detyrë lexoje me kujdes, mendo mirë se çfarë kërkohet në detyrë dhe për mënyrën sipas së cilës duhet ta zgjidhësh (duke e rrethuar, bashkuar, nënvizuar, plotësuar e të tjera).
- Shkruaj shkronjat qartë, duke pasur parasysh që përgjigjet e tua të jenë të kuptueshme, por edhe të sakta në kuptimin gramatikor dhe drejtshkrimor.
- Me rastin e zgjidhjes së detyrave në të cilat prej teje pritet që të plotësosh ndonjë gjë, gjithnjë duhet t'i përdorësh emërtimet e plota; shkurtesat nuk lejohen (psh., duhet të shkruhen emrat, e jo em. ose kallëzorja e jo kall., dhe të ngjashme).
- Plotësoje testin me **stilolaps** (gjatë zgjidhjes së detyrës duhet të përdorësh lapsin e thjeshtë dhe gomën).
- Përgjigjeve të shkruara me stilolaps nuk mund t'u biesh vizë ose t'i korrigjosh.
- Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps të thjeshtë nuk do të pranohet.
- Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shkruaj asgjë. Kjo është hapësirë në të cilën kontrolluesi do t'i shënojë pikat. Në këtë dhe në faqen e fundit gjithashtu nuk mund të shkruash asgjë.
- Nëse e mbaron më herët, dorëzoje testin dhe ngadalë dil jashtë që të mos e pengosh punën e të tjerëve.

Të dëshirojmë sukses në punë!

* Тестове, као ни делове тестова, није дозвољено јавно објављивати без претходне сагласности Завода за вредновање квалитета образовања и васпитања.

1. Lexo tekstin e poshtëshënuar dhe trego se çështë?

12.11.2016

I nderuar z. Saimir,

Unë quhem Drita Lisi dhe po ju drejtohem juve me këtë kërkesë për të ndjekur kursin e kompjuterit.

Në rast se e shihni të mundur regjistrimin tim në këtë kurs, ju lutem më dërgoni formularin me të dhënat. Njëkohësisht, unë kam nevojë të dijë edhe kushtet e tjera që lidhen me ndjekjen e kursit nga ana ime.

*Me respekt,
Drita Lisi*

Teksti i hdënë është :

- a) letër personale
- b) letër zyrtare
- c) letër falënderuese

2. Lexo me kujdes tekstin e mëposhtëm dhe treg se në ç'stil është shkruar:

Im atë rridhte nga një familje italianësh mali, të regjur me vështirësitë e jetës, ndërsa sime mëje, e cila i përkiste një familjeje të moçme shqiptare, iu desh t'i përballonte me dinjitet vuajtjet. U vendosën në Rohas, që ashtu si pjesa më e madhe e fshatrave të Pampës, ishte një nga fortesat e shumta të ndërtuara nga spanjollët që e shënonte kufirin e qytetërimit të krishterë.


Mbaj mend një plak indian, i cili duke gërshetuar gjithë durim lëkurët e kafshëve, më rrëfente anekdota luftërash të përgjakshme e pushim, e kur i kishim thënë se do të transmetonin në galenë ndeshjen e boksit mes Firpos e Dempseit, qe përgjigjur: "Kultura është bar i djallit".

Në këtë fshat të Pampës, im atë ia doli të blinte një mulli.

Qarko përgjigjen e saktë:

- a) Autobiografik;
- b) Argumentues;
- c) Informativ;

3. Në diagramin e dhënë janë paraqitur veçoritë e tekstit. Ju keni për detyrë ta plotësoni diagramin duke i treguar veçoritë e paragrafit.



Plotëso diagramin duke treguar si krijohet paragrafi.

4. Numrat e dhënë më poshtë, shkruaj me shkronja (fjalë):

639 _____

474 _____

11 _____

9 _____

3 _____

5. Renditi zanoret dhe bashkëtingëlloret e përbëra sipas rendit alfabetik:

a) i, o, ë, u, e, y, a

b) nj, ll, zh, sh, dh, xh, rr, gj, th

6. Nënvizto fjalët që janë shkruar si duhet

i bukri — i bukuri

vetulla — vetlla

sqetlla — sqetulla

noflla — nofulla

kumbulla — kumblla

aklli — akulli

7. Ndani në rrokje fjalët e poshtëshënuara:

Orendi _____

Televizion _____

Mbrëmje _____

8. Shëno theksin në fjalët e mëposhtme:

- Libri, lante, gjarpër, dhëndurë, punë

9. Shiko bashkëtingëlloret e mëposhtme me kujdes dhe rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

Bashkëtingëlloret t, d, s, z, c, x, th, dh, n, ll janë:

a) bashkëtingëllore buzore;

b) bashkëtingëllore dhëmbore.

10. Radhit fjalët duke shënuar me plus në kolonën përkatëse, sipas shembullit të dhënë:

Fjala	Emër	Mbiemër	Përemër	Folje
ndërtesë	+			
e shëmtuar				
lëviz				
i saj				
këmba				
i bukur				
cili				
vrapon				

11. *Degët e rrapit të vjetër lëkundeshin ngadalë nga era e lehtë.*

Në këtë fjali të sipërshënuar sipas kuptimit është përdorur rrethanori.

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

a) i kohës

b) i mënyrës

c) i shkakut

ç) i vendit

16. Në vitin 1555 cili libër është botuar në gjuhën shqipe?

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë:

a) Nita

b) Gjahu i malësorëve

c) Meshari

17. Lexo me kujdes vargjet e mëposhtme dhe nënvizo shkronjën përpara:

Revolucioni

*Shoku pranë shokut. Pushka pranë pushkës.
Marshojnë. Përbihen nëpër unaza t'ngushta bjeshkësh.*

*Trim mbas trimi. Zemër pranë zemrës.
Sulmojnë trollovi yjesh. Dielli ec përpara.*

*Sy pranë syrit. Dorë për dore. Me bomba.
Fluturojnë. Sutjeska. Burime gjaku derdhet në të.*

*Qëndresë mbas qëndrese. Sulm mbas sulmi.
Agimet linden gjithnjë më të kuqremta...*

*Flamur pranë flamurit. Kuq, kuq, kuq!
Dashuria pranë legjendës. Fitore mbas fitoreje.*

*Tashmë thneglat kanë dal dhe po i godasin
përsëri kasollet e tyre të djegura.*

*Liria pranë lirisë. Ardhmëria pranë ardhmërisë.
Këndojmë.*

Vargjet e lartpërmendura janë:

a) poezi

b) këngë

c) poemë

18. Në ç`vit është shkruar „Formula e pagëzimit”?

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë:

a) 1555

b) 1462

c) 1512

19. Lexo vargjet e poshtëshenuara të cilat janë marrë nga poezia “Vaje”

O ëngjell i bukur, mos mëno në botë
ktheu të të shomë, të na mbeten lotë.
S'rrojmë dot pa tynë, ti si rron pa neve?
Motmot që rrojtëm bashkë s'më hurreve.

Vargje të tilla shkruhen për njerëz të vdekur, me nota dhembjeje.

a) Si quhet ky lloj i poezisë?

b) Cili është autori i kësaj poezie ?

20. Personazhet *Hajria*, *Uka*, *Sabiti*, janë personazhet kryesor të veprës letrare :

Rretho numrin para përgjigjes së saktë:

1) Malësorja

2) Nita

3) Gavroshi

Rezultati në testin nga gjuha shqipe

Vërejtje: Nxënësit NUK e plotësojnë këtë faqe!

Rezultati në nivel të detyrës

Rezultati i përgjithshëm në test
(prej 0 deri 20)

		,	
--	--	---	--

Numri i detyrës	E pplotësuar	0 pikët	0,5 pikë	1 pikë
1.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Komisioni:

1. _____

2. _____

3. _____

Kontrolluesi:

4. _____

Shkruaj ✕ në vendin përkatës.

Shkolla	
Vendi	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	